




AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare  
dhe Banesave në Kosovë 2011

REZULTATET PËRFUNDIMTARE

# TË DHËNAT KRYESORE



Census Project Multi-Donor Trust Fund



## SHËNIM PËR LEXUESIN

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është kryer sipas metodologjisë derë-më-derë në prill të vitit 2011, me datë referimi 31 mars 2011, në mesnatë. Ai është bazuar në Ligjin për Regjistrim (03/L-237), të miratuar më 7 tetor 2010 nga Kuvendi i Kosovës. Njëra prej dispozitave më të rëndësishme të ligjit i përket mbrojtjes dhe konfidencialitetit të të dhënave personale. Ky ligj gjithashtu përcakton obligimin për të kryer anketimin pas-regjistrimit menjëherë pas regjistrimit të popullsisë.

Regjistrimi popullsisë në Kosovë është në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare për metodologjinë për regjistrimet e popullsisë dhe të ekonomive familjare 2010, të përgatitura nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë në bashkëpunim me Zyrën e Statistikave të Komuniteteve Evropiane (Eurostat). Të gjitha temat e përfshira dhe të dhënat e mbledhura u referohen definicioneve të dakorduara ndërkombëtarisht.

Të gjitha të dhënat në këtë dokument i referohen Regjistrimit të Popullsisë 2011. Rezultatet e regjistrimit përfshijnë të dhëna nga 34 komuna. Për arsye objektive nuk ka qenë e mundur që regjistrimi të zhvillohet në komunat veriore, gjë që është pranuar edhe nga Komiteti Drejtues i Fondit të Mirëbesimit të Regjistrimit. Agjencia e Statistikave të Kosovës do t'i publikojë vlerësimet për këto komuna me vonë.

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare  
dhe Banesave në Kosovë 2011

REZULTATET PËRFUNDIMTARE

# TË DHËNAT KRYESORE

## DEKLARATË MBI PËRGJEGJËSINË

Ky publikim është hartuar me ndihmën e EUCEP-it, projekt i asistencës teknike i financuar nga Bashkimi Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Asistencë teknike për Agjencinë Statistike të Kosovës për përgatitjen e regjistrimit të popullsisë

Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e BE në Kosovë i realizuar nga Istat, CIRPS- Universiteti i Romës Sapienza, ICON-INSTITUT dhe Rrota

**EUCEP** 2011  
CENSUS SUPPORT PROJECT

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
<b>FJALORI I TERMAVE</b> .....	<b>9</b>
<b>RRETH REGJISTRIMIT</b> .....	<b>18</b>
<b>KAPITULLI 1 - INFORMACION I PËRGJITHSHËM</b> .....	<b>18</b>
<b>KAPITULLI 2 - TABELAT PËRMBLEDHËSE</b> .....	<b>28</b>
Tab. 2.1 – Popullsia rezidente dhe ekonomitë familjare private .....	28
Tab. 2.2 – Arsimimi .....	29
Tab. 2.3 – Tregu i punës.....	30
Tab. 2.4 – Ndërtesat dhe banesat.....	30
Tab. 2.5 – Popullsia sipas gjinisë dhe vitit të regjistrimit .....	31
Tab. 2.6 – Popullsia sipas grupmoshës dhe vitit të regjistrimit .....	31
Tab. 2.7 – Treguesit e strukturës së moshës sipas vitit të regjistrimit .....	31
<b>KAPITULLI 3 - POPULLSIA, EKONOMITË FAMILJARE DHE NJËSITË E BANIMIT NË KOSOVË</b> .....	<b>32</b>
Tab. 3.1 – Popullsia e zakonshme sipas gjinisë dhe viteve të vetme të moshës.....	32
Tab. 3.2 – Popullsia rezidente sipas grupmoshës, gjinisë dhe madhësisë së vendbanimit.....	35
Tab. 3.3 – Popullsia sipas moshave, gjinisë dhe llojit të vendbanimit (urbane/rurale).....	41
Tab. 3.4 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeçe e mbi sipas gjinisë, llojit të vendbanimit (urbane/rurale) dhe statusit martesor .....	43
Tab. 3.5 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeçe e mbi sipas statusit martesor, gjinisë dhe moshës .....	44
Tab. 3.6 – Popullsia rezidente e moshës 1 vjeç e mbi që kanë jetuar ndonjëherë jashtë vendit, sipas vitit të ardhjes në Kosovë, gjinisë dhe vendit të banimit të mëparshëm të zakonshëm (10 vendet e para).....	45
Tab. 3.7 – Popullsia rezidente e moshës 1 vjeçe e me shume që ndonjëherë ka banuar në një vend të ndryshëm nga ai i tanishmi sipas arsyes së shkuarjes, gjinisë dhe moshës.....	47
Tab. 3.8 – Popullsia rezidente e moshës 1 vjeçe e mbi sipas vendit të zakonshëm të banimit 1 vit para regjistrimit, gjinisë dhe moshës.....	49
Tab. 3.9 – Popullsia rezidente e moshës 1 vjeç e mbi sipas moshës, gjinisë dhe vendit të banimit të zakonshëm 1 vit para regjistrimit .....	51
Tab. 3.10 – Popullsia rezidente sipas vendit të lindjes, gjinisë dhe moshës .....	54
Tab. 3.11 – Popullsia rezidente e lindur në Kosovë sipas moshës, gjinisë dhe komunës së lindjes .....	56
Tab. 3.12 – Popullsia rezidente e lindur jashtë vendit sipas moshës, gjinisë dhe vendit të lindjes.....	59
Tab. 3.13 – Popullsia rezidente sipas përkatësisë etnike/kulturore, gjinisë dhe moshës .....	60
Tab. 3.14 – Popullsia rezidente sipas religjionit, gjinisë dhe moshës .....	62
Tab. 3.15 – Popullsia rezidente sipas gjuhës amtare, gjinisë dhe moshës .....	64
Tab. 3.16 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas numrit të gjuhëve të folura të ndryshme nga gjuha amtare, gjinisë dhe moshës .....	66

Tab. 3.17 – Gjuhët e folura të ndryshme nga gjuha amtare sipas gjinisë dhe moshës së popullsisë së moshës 15 vjeçe e mbi.....	67
Tab. 3.18 – Popullsia rezidente sipas moshës, gjinisë dhe vendit të nënshtetësisë.....	68
Tab. 3.19 – Femrat e moshës 15 vjeç e mbi sipas numrit të fëmijëve të lindur të gjallë dhe moshës.....	69
Tab. 3.20 – Femrat e moshës 15 vjeç e mbi (me fëmijë të lindur të gjallë pas vitit 2005) sipas numrit të fëmijëve të lindur të gjallë pas vitit 2005 dhe numri i vdekjeve para moshës 1 vjeçe.....	70
Tab. 3.21 – Popullsia rezidente e moshës 6 deri 29 vjeç sipas vijueshmërisë së shkollimit, gjinisë dhe viteve të vetme të moshës.....	71
Tab. 3.22 – Popullsia rezidente e moshës 6 deri 29 vjeç që vijojnë shkollimin sipas shkollës që vijojnë aktualisht, gjinisë, viteve dhe moshës.....	74
Tab. 3.23 – Popullsia rezidente e moshës 10 vjeç e mbi që nuk e ka përfunduar nivelin e shkollimit sipas shkrim -leximit (analfabet), gjinisë dhe moshës.....	77
Tab. 3.24 – Popullsia rezidente e moshës 10 vjeç e mbi me nivel të përfunduar shkollimi sipas nivelit më të lartë të shkollimit të përfunduar, gjinisë dhe moshës.....	79
Tab. 3.25 – Popullsia rezidente e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të veprimtarisë aktuale, gjinisë dhe moshës.....	81
Tab. 3.26 – Popullsia rezidnete e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të veprimtarisë aktuale, gjinisë dhe nivelit të arsimimit.....	82
Tab. 3.27 – Të punësuarit sipas moshës, gjinisë dhe profesionit kryesor.....	84
Tab. 3.28 – Të punësuarit sipas moshës, gjinisë dhe veprimtarive kryesore.....	87
Tab. 3.29 – Të punësuarit sipas statusit kryesor të punësimit, gjinisë dhe moshës.....	93
Tab. 3.30 –Të punësuarit sipas statusit kryesor të punësimit, gjinisë dhe veprimtarisë kryesore.....	94
Tab. 3.31 – Të punësuarit sipas statusit kryesor të punësimit, gjinisë dhe profesionit kryesor.....	97
Tab. 3.32 – Të punësuarit sipas numrit të orëve të punës në punën kryesore në javën para regjistrimit, gjinisë dhe moshës.....	100
Tab. 3.33 – Të punësuarit sipas numrit të orëve të zakonshme të punës për javë në punën kryesore, gjinisë dhe moshës.....	101
Tab. 3.34 – Të punësuarit sipas llojit të vendit të punës, gjinisë dhe moshës.....	102
Tab. 3.35 – Të punësuarit që udhëtojnë shtëpi-punë dhe anasjelltas sipas vendit të punës, gjinisë dhe moshës.....	103
Tab. 3.36 – Të punësuarit që udhëtojnë shtëpi-punë dhe anasjelltas sipas vendit të punës (Kosovë/jashtë vendit), shpeshësia e udhëtimit të rregullt vajtje-ardhje, gjinisë dhe moshës.....	104
Tab. 3.37 – Popullsia ekonomikisht jo-aktive sipas kategorisë funksionale, gjinisë dhe moshës.....	105
Tab. 3.38 – Popullsia rezidente sipas numrit të vështirësive afatgjate, gjinisë dhe moshës.....	106
Tab. 3.39 – Popullsia rezidente me së paku një vështirësi afatgjate, sipas gjinisë dhe moshës.....	108
Tab. 3.40 – Popullsia rezidente me vështirësi afatgjate, sipas moshës, shkallës së vështirësisë në kryerjen e aktiviteteve ditore dhe aktivitetit ditor.....	110
Tab. 3.41 – Popullsia rezidente sipas burimit kryesor të jetesës në vitin para regjistrimit, gjinisë dhe moshës.....	111
Tab. 3.42 – Popullsia rezidente sipas dy burimeve kryesore të jetesës në vitin para regjistrimit.....	112
Tab. 3.43 – Popullsia rezidente sipas statusit të ekonomisë familjare, gjinisë dhe moshës.....	112

Tab. 3.44 – Popullsia rezidente në ekonomi familjare private sipas statusit familjar, gjinisë dhe moshës .....	114
Tab. 3.45 –  Ekonomitë familjare private sipas numrit të familjeve dhe numrit të anëtarëve të ekonomisë familjare .....	116
Tab. 3.46 – Ekonomitë familjare private sipas llojit .....	116
Tab. 3.47 – Familjet sipas llojit .....	117
Tab. 3.48 – Ekonomitë familjare private sipas llojit të banesës dhe numrit të anëtarëve të ekonomisë familjare .....	117
Tab. 3.49 – Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas statusit të banimit dhe numrit të anëtarëve të ekonomisë familjare. ....	118
Tab. 3.50 – Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas tipit të vendbanimit (urbane/rurale), posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet.....	118
Tab. 3.51 – Ekonomitë familjare private sipas tokës në pronësi apo në shfrytëzim .....	119
Tab. 3.52 – Popullsia rezidente në ekonomitë familjare institucionale sipas moshës, gjinisë dhe llojit .....	120
Tab. 3.53 – Personat përkohësisht të pranishëm në kuarte të banimit kolektiv sipas moshës, gjinisë dhe llojit.....	121
Tab. 3.54 – Personat përkohësisht të pranishëm në ekonomi familjare institucionale sipas moshës, gjinisë dhe llojit.....	122
Tab. 3.55 – Ekonomitë familjare institucionale sipas numrit të personave në ekonominë familjare institucionale, gjinisë dhe llojit të ekonomisë familjare institucionale .....	124
Tab. 3.56 – Njësitë e banimit të banuara sipas llojit dhe posedimit të infrastrukturës themelore .....	126
Tab. 3.57 – Njësitë e banimit të shfrytëzuara sipas llojit të njësisë së banimit dhe llojit të pronësisë .....	127
Tab. 3.58 – Banesat e zakonshme sipas tipit të vendbanimit (urbane/rurale) dhe statusit të banimit .....	127
Tab. 3.59 – Banesat e banuara të zakonshme sipas periudhës së ndërtimit të ndërtesës dhe materialeve ndërtimore të mureve të jashtme .....	127
Tab. 3.60 – Banesat e banuara të zakonshme sipas numrit të banorëve dhe hapsirës së shfrytëzueshme (në metër katror).....	128
Tab. 3.61 – Ndërtesat sipas numrit të banesave të banuara të zakonshme dhe llojit të ndërtesës .....	128
Tab. 3.62 – Ndërtesat sipas numrit të banesave të banuara të zakonshme dhe periudhës së ndërtimit të ndërtesës .....	128
Tab. 3.63 – Ndërtesat sipas numrit të kateve dhe materialeve ndërtimore të mureve të jashtme .....	129

#### **KAPITULLI 4 - INDIKATORËT PËR ANALIZA TERRITORIALE ..... 130**

Tab. 4.1 – Raporti gjinor, raporti i plakjes, raporti i varësisë, % e popullsisë së moshës 75 vjeç e me teper në popullsinë e përgjithshme, sipas komunës. ....	130
Tab. 4.2 – Numri i ndërtesave me së paku një banesë të shfrytëzuar të zakonshme, numri mesatar i banesave për ndërtesë, numri i banesave të zakonshme, numri i banesave të zbrazëta, sipas komunës .....	131
Tab. 4.3 – Numri i banesave të shfrytëzuara të zakonshme, numri mesatar i ekonomive familjare për banesë, sipërfaqja mesatare e shfrytëzuar për kokë banori, sipas komunës. ....	132

## **KAPITULLI 5 - POPULLSIA, EKONOMITË FAMILJARE DHE NJËSITË E BANIMIT NË KOMUNAT E KOSOVËS ..... 134**

Tab 5.1 - Popullsia sipas moshës, gjinisë dhe komunës.....	134
Tab 5.2 - Popullsia sipas statusit martesor, gjinisë dhe komunës.....	137
Tab. 5.3 – Popullsia sipas vendit të lindjes, gjinisë dhe komunës .....	140
Tab 5.4 - Popullsia sipas përkatësisë etnike/kulturore, gjinisë dhe komunës .....	143
Tab 5.5 - Popullsia sipas religjionit, gjinisë dhe komunës .....	146
Tab 5.6 - Popullsia sipas gjuhës amtare, gjinisë dhe komunës .....	149
Tab. 5.7 – Popullsia sipas vendit të shtetësisë, gjinisë dhe komunës .....	152
Tab. 5.8 - Popullsia 6 deri 29 vjeç që aktualisht vijon shkollimin sipas nivelit, gjinisë dhe komunës.....	155
Tab. 5.9 – Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit, njohjes së shkrim-leximit, gjinisë dhe komunës.....	158
Tab. 5.10 – Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual, gjinisë dhe komunës.....	161
Tab. 5.11 – Të punësuar sipas profesionit kryesor, gjinisë dhe komunës .....	164
Tab. 5.12 – Të punësuarit sipas veprimtarisë kryesore, gjinisë dhe komunës .....	170
Tab. 5.13 – Të punësuar sipas llojit të vendit të punës, gjinisë dhe komunës .....	176
Tab. 5.14 – Të punësuarit që udhëtojnë shtëpi-punë dhe anasjelltas sipas vendit të punës, gjinisë dhe komunës .....	179
Tab. 5.15 – Personat e moshës 15 vjeç e mbi ekonomikisht jo aktive sipas kategorisë funksionale, gjinisë dhe komunës.....	182
Tab. 5.16 – Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës, gjinisë dhe komunës .....	185
Tab. 5.17 – Popullsia rezidente sipas statusit të ekonomisë familjare, gjinisë dhe komunës .....	188
Tab. 5.18 – Ekonomitë familjare private sipas numrit të anëtarëve dhe komunës .....	191
Tab. 5.19 – Popullsia rezidente në ekonomi familjare private sipas statusit familjar, gjinisë dhe komunës.....	192
Tab. 5.20 – Ekonomitë familjare institucionale sipas llojit dhe komunës .....	195
Tab. 5.21 – Personat rezident në ekonomitë familjare institucionale sipas llojit të ekonomisë familjare institucionale, gjinisë dhe komunës.....	196
Tab. 5.22 – Persona përkohësisht të pranishëm në ekonomitë familjare institucionale sipas llojit të ekonomisë familjare institucionale, gjinisë dhe komunës .....	199
Tab. 5.23 – Ekonomitë familjare private sipas statusit të banimit dhe komunës .....	202
Tab. 5.24 – Ekonomitë familjare private sipas statusit të banimit të ekonomisë familjare dhe komunës .....	203
Tab. 5.25 – Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet .....	204
Tab. 5.26 – Banesat e zakonshme sipas posedimit të infrastrukturës themelore dhe komunës .....	205
Tab. 5.27 – Banesat e zakonshme sipas statusit të shfrytëzimit, llojit të pronësisë dhe komunës .....	206
Tab. 5.28 – Banesat e banuara të zakonshme sipas periudhës së ndërtimit të ndërtesës dhe komunës .....	207
Tab. 5.29 – Ndërtesat me së paku një banesë të zakonshme të banuar dhe komunës .....	208

# Hyrje

## REZULTATET PËRFUNDIMTARE te dala nga regjistrimi i popullsisë 2011

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë është realizuar në prill të vitit 2011. Regjistrimi i fundit i vlefshëm në Kosovë është realizuar para tri dekadave, në vitin 1981.

Regjistrimi është realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në bashkëpunim me Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR) që ishin krijuar nëpër komunat e Kosovës nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit<sup>1</sup>.

Regjistrimi është bazuar në Ligjin nr. 03/L-237 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në tetor të vitit 2010.

Regjistrimi po ashtu është bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian për Statistika (KES), për raundin e regjistrimeve të 2010-ës dhe Rregulloren e KE, nr. 763/2008 për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli më datën 9 korrik 2008.

Në përputhje me dispozitat e ligjit të regjistrimit, ASK-ja ka publikuar të dhënat paraprake për disa indikatorë me datën 29 qershor 2011; ligji përcakton se të gjitha të dhënat përfundimtare duhet të publikohen deri në fund të vitit 2013.

Mbledhja e të dhënave në terren është bërë nga data 01 prill deri me 15 prill 2011. Me kërkesë të disa komunave (7 komunave), regjistrimi është shtyrë për 4 ditë .

Procesi i regjistrimit të popullsisë në Kosovë gjatë të gjitha fazave të tij është monitoruar nga afër prej Operacionit Monitorues Ndërkombëtar (IMO) i përbërë prej Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian,

Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropë (UNECE) dhe Divizionit të Kombeve të Bashkuara për Statistika (UNSD). EUROSTAT-i ishte në krye të ekipit.

Projekti i regjistrimit të popullsisë ka pranuar asistencë teknike të financuar nga Bashkimi Evropian.

Në fund falënderojmë të gjithë ata që kontribuan në projektin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.



**Isa Krasniqi**

*Kryeshef i Agjencisë së Statistikave të Kosovës*

<sup>1</sup> Për më shumë shih në ueb faqen e ASK-së: Raporti i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011 (faqe 6-9)

<sup>2</sup> Për më shumë shih në ueb faqen e ASK-së: Raporti i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011 (faqe 33-34)

<sup>3</sup> Për më shumë shih në ueb faqen e ASK-së: Raporti i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011 (faqe 13)



# Fjalori i termave

## PËRKUFIZIMET KRYESORE TË TEMAVE / VARIABLAT E PËRGJITHSHME

### Popullsia

Popullsia nënkupton të gjithë personat që kanë qenë banorë të zakonshëm në Kosovë për të paktën 12 muaj deri në datën e regjistrimit; personat që kanë status diplomatik, personeli i huaj ushtarak dhe personat që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm jashtë Kosovës, nuk përfshihen.

### Ekonomia familjare

Ekonomia familjare përfshinë të gjithë personat që jetojnë në një banesë të përbashkët dhe që kanë të përbashkëta mjetet kryesore të jetesës. Ekonomia familjare këtu i referohet konceptit të ekonomisë familjare private, për dallim nga ekonomitë kolektive siç janë grupet fetare, qendrat shëndetësore, jetimoret, etj.

### Ekonomi familjare institucionale

Tërësi ligjore e destinuar për banim afatgjatë dhe për ofrimin e përkujdesjes institucionale që u jepet një grupi personash. Eurostat i rekomandon këtë klasifikim:

1. Institucionet arsimore
2. Institucionet shëndetësore
3. Institucionet për pensionistë ose të moshuar
4. Institucionet ushtarake
5. Institucionet fetare
6. Institucionet e tjera

### Familje

Dy ose më shumë persona që jetojnë bashkë e që janë në lidhje familjare të shkallës së parë, siç janë një çift me fëmijë ose pa fëmijë, ose një prind i vetëm me së paku një fëmijë; sipas përkufizimit të regjistrimit të popullsisë, gjyshja me nipin/mbesën ose dy vëllezër pa prindër nuk konsiderohen si një familje.

### Ndërtesë

Çdo strukturë e pavarur e cila përmban një ose më shumë banesa, dhoma ose hapësira të tjera, të mbuluara me një kulm dhe të rrethuara me mure të jashtme ose mure ndarëse që shtrihen nga themeli deri në kulm, qoftë ajo e dizajnuar për banim apo për qëllime bujqësore, komerciale, industriale ose kulturore apo për ofrimin e shërbimeve.

### Njësi e banimit, e quajtur edhe banesë

Banesë konvencionale apo vend jokonvencional i banimit të zakonshëm ku njerëzit janë duke jetuar në kohën e regjistrimit të popullsisë.

### Urbane

Një zonë e urbanizuar gjeografike - e definuar në nivelin të vendbanimit - karakterizohet me densitet më të madh të popullsisë dhe tipare të mëdha njerëzore krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë një zonë është përkufizuar si urbane me vendim administrativ të komunës.

### Rurale

Zonë gjeografike jo e urbanizuar - e përkufizuar në nivel vendbanimi - që karakterizohet me densitet më të ulët të popullsisë dhe zakonisht shumica e tokës shfrytëzohet për bujqësi krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë një zonë është përkufizuar si rurale me vendim administrativ të komunës.

### Popullsia e moshës 1 vjeçe e mbi

Përkufizimi i përdorur për të gjitha variablat lidhur me gjendjen e personit të intervistuar një vit ose më shumë para regjistrimit; p.sh., vendi i banimit të zakonshëm një vit para regjistrimit nuk vlen për foshnjat e lindura gjatë vitit të fundit.

### Popullsia e moshës 15 vjeçe e mbi

. Përkufizimi i përdorur për të gjitha variablat lidhur me gjendjen e personit të intervistuar bazuar në moshën e ligjore; p.sh., mosha ligjore për të punuar, mosha ligjore për tu martuar, etj.

### KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË NDËRTESAVE

#### Ndërtesë banimi

*Ndërtesë e dizajnuar për banim.*

#### Shtëpi e veçuar

*Shtëpi individuale që nuk është e ngjitur me asnjë objekt tjetër .*

#### Shtëpi gjysmë e veçuar

*Dy shtëpi të ngjitura njëra me tjetrën.*

#### Resht apo varg shtëpish

*Ndërtim prej tri ose më shumë shtëpish ngjitura njëra me tjetrën, secila me hyrje të veçantë të jashtëm.*

#### Ndërtesë ose bllok banesash

*Objekt banesor që përmban tri ose më shumë banesa pa hyrje të veçantë nga jashtë.*

#### Ndërtesë që nuk është për banim

*Ndërtesë që nuk është dizajnuar për banim por që përdoret nga së paku një person për banim të zakonshëm në kohën e regjistrimit.*

#### Numri i kateve të ndërtesës

*Numri i kateve llogaritet nga kati përdhese e përpjetë, përfshirë edhe vet katin përdhese*

#### Viti i ndërtimit të ndërtesës

*Viti në të cilin është përfunduar ndërtesa ose viti në të cilin janë përfunduar ndryshime të mëdha në konstruksion, nëse ka pasur të tilla.*

### KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË BANESAVE/NJËSIVE TË BANIMIT

#### Kuart i banimit kolektiv

*Kuartet e banimit kolektiv përfshijnë vendet strukturalisht të veçanta dhe të pavarura të banimit të destinuar për banim të një grupi më të madh personash ose disa ekonomive familjare dhe që janë në shfrytëzim në kohën e regjistrimit. Kuartet e tilla zakonisht kanë disa pjesë të përbashkëta, siç janë instalimet për përgatitje të ushqimit dhe tualetet, banjot, dhomat e ndejës ose të fjetjes, që shfrytëzuesit i kanë të përbashkëta. Kuartet e banimit kolektiv mund të klasifikohen më tej në hotele, shtëpi me dhoma dhe shtëpitë e tjera për tu lëshuar me qira, institucionet dhe kampet.*

#### Banesë konvencionale

*Dhoma ose suitë dhomash dhe pjesët e tyre ndihmëse (paradhomat, korridoret, etj) në një ndërtesë të përhershme ose ndonjë pjesë të saj me strukturë të veçantë të dizajnuar (ose e shndërruar) për banim të përhershëm, siç është shtëpia ose banesa. Ajo duhet të jetë e rrethuar me mure dhe e mbuluar me kulm dhe duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë nga rruga ose nga shkallët publike ose të përbashkëta, korridor, galeri apo vende tjera (d.m.th, kur shfrytëzuesit mund të hyjnë dhe dalin pa kaluar nëpër banesën e ndonjë ekonomie tjetër familjare).*

#### Banesë jo-konvencionale (ose lloji tjetër i njësisë banesore)

*Njësi e banimit e cila është mobile (p.sh. tendë ose karavan), gjysmë e përhershme (p.sh. kasolle ose shtëpizë verimi), e improvizuar (p.sh. rrogoz ose barakë) ose që nuk është e dizajnuar për banim të njerëzve (p.sh. garazh, shitore, strehë natyrore) por që në kohën e regjistrimit të popullsisë është duke u përdorur për banim të zakonshëm nga një apo më shumë persona.*

#### Të pastrehët

*Njerëz të pa strehë (që flenë rrugëve) ose pa vend të zakonshëm të banimit që lëvizin shpesh nga një lloj i banimit në tjetrin.*

#### Banеса të banuara (të quajtura edhe banesa të shfrytëzuara)

*Banesa është e banuar nga personat që përfshihen në regjistrimin e popullsisë (njësia e banimit ) ku zakonisht jeton një ose më shumë persona), pavarësisht se a kanë munguar përkohësisht apo jo në ditën e regjistrimit.*

**E shfrytëzuar nga banues që nuk përfshihen në regjistrim**

Banesa është e banuar nga personat që nuk përfshihen në regjistrim të popullsisë si diplomatët dhe anëtarët e familjeve të tyre, personeli i huaj ushtarak, personat që zakonisht jetojnë jashtë vendit, njerëzit që kanë vendin e zakonshëm të banimit diku tjetër, etj.

**E rezervuar për qëndrim sezonal/të rastit ose shfrytëzim dytësor**

Banesa përdoret vetëm për pushime, gjatës stinës së verës, për punë sezonale, ose për ndonjë qëndrim tjetër të rastit. Megjithatë ajo nuk është vendi kryesor i banimit të zakonshëm.

**Banesa të zbrazëta**

Banesa përshkruhet si e zbrazët nëse në të nuk ka banorë të zakonshëm në kohën e regjistrimit por që është në dispozicion të bëhet banesë e zakonshme për së paku një person (për shembull banesa të zbrazëta për tu lëshuar me qira ose për shitje dhe banesat e ekonomive familjare që punojnë jashtë vendit, nëse nuk jeton askush në to).

**Banesat e pabanuara ose të pashfrytëzuara**

Një banesë konsiderohet «e pabanuar» ose «e pashfrytëzuar» kur askush nuk jeton në të tërë kohën. Mund të ketë persona që përkohësisht janë aty, por që zakonisht jetojnë diku tjetër (mund të jetë banesë e rezervuar për shfrytëzim sezonal apo dytësor) ose nga personat që nuk përfshihen në regjistrimin e popullsisë (siç janë personeli diplomatik) ose mund të jetë banesë e zbrazët (siç janë banesat për tu lëshuar me qira ose për shitje).

**Dhoma**

Njësia hapësinore e banimit e destinuar për jetesë, e ndarë nga dhomat e tjera me mure stabile (që janë nga dyshemeja deri në tavan apo në kulm), me lartësi së paku 2 metra, e madhësisë së mjaftueshme për të zënë një shtrat për të rritur (së paku 4 metra katrorë) dhe së paku 2 metra e lartë mbi zonën kryesore të tavanit. Prandaj, dhomat normale të fjetjes, të ngrënies, të ditës, bodrumet e banueshme dhe papafingot, kuzhinat dhe hapësirat e tjera të ndara që përdoren ose që janë të destinuara për banim numërohen si dhoma (nëse i përgjigjen përkufizimit të dhënë më lartë). Në të kundërtën, aneksi i kuzhinës (d.m.th. kuzhina më e vogël se 4 metra katrorë), verandat, dhomat ku lihen pajisjet shtëpiake (p.sh. dhoma e bojlerit, dhoma për larjen e rrobave) dhe paradhomat nuk numërohen si dhoma; e as banjot dhe tualetet (edhe nëse janë më të mëdha se 4 metra katrorë). Dhomat pa dritare (p.sh. bodrumet nën tokë) nuk përfshihen përveç nëse ato për nga funksioni përdoren për qëllime shtëpiake (p.sh. dhomat e brendshme të fjetjes që nuk kanë dritare). Dhomat e ndara nga banesa por që funksionojnë bashkë me të dhe që përdoren nga ekonomia familjare, konsiderohen pjesë e banesës dhe përfshihen në numrin e përgjithshëm të dhomave.

**Dhomat, përfshirë edhe ato për qëllime biznesi apo profesionale**

Dhomat e banesës të destinuara për jetesë bashkë me dhomat e njësisë banesore që përdoren për qëllime biznesi apo profesionale

**Sistemi i furnizimit me ujë nga një shërbim publik**

Furnizimi me ujë bëhet përmes gypave (uji nga rubineti) dhe shpërndahet nga ofruesi publik i shërbimit (shembull i kësaj është sistemi i ujësjellësit komunal

**Sistemi i furnizimit me ujë nga shërbimet jo-publike**

Furnizimi me ujë bëhet përmes gypave (uji nga rubineti) por nuk shpërndahet sipas skemës së shërbimit publik. Kjo ndodh në rastet kur uji nga ndonjë burim apo pus, me ndihmën e pompave, përmes gypave futet në shtëpi (veçanërisht në zonat rurale) ose nga ndonjë ujëvarë natyrore (veçanërisht në zonat malore)

**Sistemi i furnizimit me ujë brenda ndërtesës por jashtë banesës**

Qasja në ujë është jashtë njësisë banesore dhe mund të jetë e përbashkët me banesat e tjera brenda ndërtesës.

**Sistemi i furnizimit me ujë jashtë ndërtesës**

Qasja në ujë ekziston vetëm jashtë ndërtesës.

**Nuk ka sistem të furnizimit me ujë**

Nuk ka fare sistem të furnizimit me ujë (as në njësinë banesore e as jashtë ndërtesës).

**Tualet me shpëlarje jashtë njësisë së banimit por brenda ndërtesës**

*Ka tualet më shpëlarje brenda ndërtesës por jashtë njësisë së banimit. Qasja në tualet po ashtu mund të jetë e përbashkët me banesat e tjera brenda ndërtesës.*

### **Tualet me shpëlarje jashtë ndërtesës**

*Qasja në tualet me shpëlarje ka vetëm jashtë ndërtesës.*

### **Nuk ka tualet me shpëlarje**

*Nuk ka tualet me shpëlarje (veçanërisht në zonat rurale) dhe mund të përdoren tualetet e thata (të ashtuquajturat 'nevojtores')*

### **Me dush apo vaskë të fiksuar**

*Ka qasje në të paktën një dush apo vaskë të fiksuar në banesë.*

### **Nuk ka dush apo vaskë të fiksuar**

*Në banesë nuk ka as dush e as vaskë të fiksuar.*

### **Kuzhina**

*Në banesë ka një kuzhinë me të paktën 4 m<sup>2</sup>.*

### **Aneksi i kuzhinës**

*Banesa ka një aneks kuzhine më të vogël se 4m<sup>2</sup>.*

### **Pajisjet e gatimit gjenden në një dhomë tjetër**

*Për shembull, vendet ku njerëzit përgatisin ushqimin në stufën e drurit që gjendet në dhomën e ditës.*

### **Nuk ka kuzhinë**

*Në banesë nuk ka fare pajisje për gatim.*

### **Ngrohja qendrore nga sistemi i ngrohjes publike**

*Ngrohja qendrore ofrohet nga sistemi i ngrohjes qendrore. Ky mund të jetë rasti vetëm në komunat e Prishtinës dhe Gjakovës të cilat kanë këtë lloj të sistemit të centralizuar të ngrohjes.*

### **Ngrohja qendrore nga sistemi i ngrohjes i instaluar në ndërtesë ose në njësinë e banimit.**

*Bojleri i pavarur i ngrohjes qendrore brenda banesës ose brenda ndërtesës.*

### **Stufa**

*Aparat i lëvizshëm ose i fiksuar që jep nxehtësinë për ngrohje, gatim, etj, e që zakonisht shfrytëzon vetëm thëngjillin, naftën, gazin apo drurin si lëndë të parë.*

### **Oxhaku**

*Pjesa e oxhakut e cila është e hapur në dhomë në të cilën digjet lënda djegëse ose ndonjë strukturë tjetër e hapur, zakonisht në mur, për të ndezur zjarrin.*

### **Ngrohëse elektrike e lëvizshme**

*Aparat i lëvizshëm që liron nxehtësi për ngrohje dhe që përdor rrymën elektrike si burim të energjisë.*

### **Lloj tjetër i ngrohjes**

*Për shembull sistemi i ngrohjes solare.*

### **Nuk ka ngrohje fare**

*Nuk ka sistem të ngrohjes në banesë.*

### **Lloji kryesor i energjisë që përdoret për ngrohje**

*Në rast se përdoret më shumë se një burim i energjisë, shkruhet ai që përdoret më rregullisht.*

### **Druri**

*Drutë e zjarrit të përshtatshme si lëndë djegëse.*

**Thëngjilli**

*Thëngjilli i përshtatshëm si lëndë djegëse.*

**Nafta**

*Çdo kategori e lëngshme që digjet e që është e përshtatshme për ngrohje (nafta, mbetjet e lëndës së parë, benzina).*

**Gazi**

*Gazi i përshtatshëm për ngrohje (gazi natyror ose gazi butan/ propan) në cilindrat e gazit).*

**Tjetër lloj energjie**

*Për shembull energjia solare.*

**RREGULLIMET KRYESORE TË EKONOMIVE FAMILJARE****Anëtar i ekonomisë familjare**

*Çdo person me banim të zakonshëm në ekonominë familjare.*

**Ekonomia familjare me shumë persona**

*Grup prej dy ose më shumë personash që mund të jenë apo të mos jenë të afërt me njëri tjetrin dhe të cilët bëhen bashkë për të shfrytëzuar në tërësi ose pjesërisht një njësi banesore dhe për t'i siguruar vetes ushqim dhe gjëra të tjera të nevojshme për jetesë. Anëtarët e grupit mund të bashkohen të ardhurat e tyre në shkallë më të madhe apo më të vogël. Ekonomia familjare mund të përbëhet nga një ose më shumë familje.*

**Ekonomi familjare me një person**

*Një person që jeton vetëm në një njësi të veçantë banesore ose që e shfrytëzon, si banues, një dhomë (ose dhoma) të veçantë të njësisë banesore por që nuk bashkohet me asnjë shfrytëzues tjetër të njësisë banesore për të krijuar ekonomi familjare me shumë persona.*

**Ekonomia familjare pa asnjë familje**

*Banesa ku jeton një person i vetëm ose të cilën e ndanë ekskluzivisht me njerëz me të cilët nuk është i afërt ose që nuk i përkasin një familjeje sipas përkufizimit të regjistrimit, për shembull, bashkëbanuesit ose partnerët e pamartuar, vëllezërit, etj.*

**Ekonomi familjare me një familje**

*Ekonomi familjare e përbërë vetëm nga një familje.*

**Familje me burrë- grua, partnerë me kurorë**

*Familje me të paktën një çift të ligjshëm burrë-grua, me ose pa fëmijë.*

**Familje me burrë- grua, partnerë pa kurorë**

*Familje me të paktën një çift joformal burrë-grua (bashkim i palegalizuar), me ose pa fëmijë*

**Familje me baba të vetëm**

*Familje ku prindi është mashkull, pa partner por me të paktën një fëmijë.*

**Familje me nënë të vetme**

*Familje ku prindi është femër, pa partner por me të paktën një fëmijë.*

**Familjet sipas fëmijëve****Familjet pa fëmijë që banojnë me ta**

*Çifti burrë-grua (me ose pa bashkim të legalizuar) që jetojnë pa asnjë fëmijë të tyre.*

**Me të paktën një fëmijë të moshës nën 25 vjeçe**

*Çifti burrë-grua (me ose pa bashkim të legalizuar) që jetojnë me të paktën një fëmijë të tyre nën moshën 25 vjeçe.*

**Me fëmijën më të vogël të moshës mbi 25 vjeçe**

## Fjalori i termave

---

Çifti burrë-grua (me ose pa bashkim të legalizuar) që jetojnë së paku me një fëmijë të tyre, e që më i riu nga ta është mbi 25 vjeçar.

### Kryefamiljari

Personi i cili është deklaruar si person referues në ekonominë familjare. Lidhjet e të gjithë anëtarëve të tjerë të ekonomisë familjare janë dhënë në raport me këtë person. Për shembull, nëse kryefamiljari është «Z. Bardhi», partnerja e tij që jeton me të do të deklarohet si «gruaja e z. Bardhit», vëllai i tij që jeton me të do të deklarohet si «vëllai i z. Bardhit» dhe gruaja e vëllait të tij do të deklarohet si «kunata e z. Bardhit».

### Statusi familjar

Pozita e personit në një familje, varësisht nga partneri i tij/saj ose raporti hierarkik: p.sh, burri, gruaja, fëmija, prindi i vetëm, etj.

### Partneri i martuar

Partneri mashkull ose femër i bashkimit të legalizuar në familje.

### Partner pa kurorë

Partneri mashkull ose femër i bashkimit të palegalizuar në familje.

### Prind i vetëm

Babai apo nëna me së paku një fëmijë, por që jetojnë pa partnerin/partneren e tij/saj.

### Pa partner në familje

Prindi i vetëm që nuk ka lidhje me ndonjë partner.

### Me partner që jeton jashtë Kosovës

Prindi i vetëm jeton pa partner por megjithatë ka lidhje me një partner që jeton jashtë Kosovës.

### Fëmija nën moshën 25 vjeçe

Së paku një fëmijë është i moshës 24 vjeçe ose më pak.

### I të dy prindërve

Fëmija jeton me të dy prindërit.

### Vetëm i njërit partner

Fëmija jeton vetëm me njërin prej prindërve.

### I prindit të vetëm pa partner në familje

Fëmija jeton vetëm me babanë ose nënën, dhe prindi nuk ka më partner.

### I prindit të vetëm me partner që jeton jashtë Kosovës

Fëmija jeton vetëm me babanë ose nënën, por prindi ka një partner që jeton jashtë Kosovës.

### Fëmija i moshës 25 vjeçe apo më shumë

Fëmija është 25 vjeçar ose më shumë.

### Person që nuk është në familje

Personi nuk jeton në familje sipas përkufizimit të regjistrimit.

### Mosha

Mosha llogaritet në vite të plota, p.sh, në personat e moshës 25 vjeçe hyjnë të gjithë ata persona që në datën e regjistrimit tashmë kanë festuar ditëlindjen e 25-të, fëmijët e porsalindur që akoma nuk kanë festuar ditëlindjen e parë konsiderohen të moshës 0 vjeçe.

### Raporti me kryefamiljarin

#### Burrë-grua me kurorë

Burri ose gruaja e kryefamiljarit, me bashkim të legalizuar.

#### Burrë-grua pa kurorë

*Burri ose gruaja e kryefamiljarit me bashkim të pa-legalizuar (de facto bashkimi njihet në aspektin shoqëror si martesë).*

#### **Gruaja e dytë**

*Gruaja e dytë e kryefamiljarit që jeton edhe me gruan e parë të tij.*

#### **Biri/ bija**

*Biri/ bija e kryefamiljarit.*

#### **Dhëndri apo reja e kryefamiljarit**

*Dhëndri apo reja (nusja e djalit) e kryefamiljarit.*

#### **Babai/ nëna**

*Babai ose nëna e kryefamiljarit.*

#### **Vëllai/ motra**

*Vëllai ose motra e kryefamiljarit.*

#### **Nipi/ mbesa**

*Nipi ose mbesa e kryefamiljarit.*

#### **Të afërmit e tjerë**

*Të afërmit e tjerë të kryefamiljarit, p.sh, gjyshi, xhaxhai/ halla, dhëndri/kunata, nipi/mbesa, kushëri, etj.*

#### **Ata që nuk janë të afërm**

*Anëtari i ekonomisë familjare që nuk është i afërm i kryefamiljarit, p.sh, miku, nikoqiri, shërbëtori, mjeku i familjes personi nën përkujdesje (arrest), etj.*

### **KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË EKONOMIVE FAMILJARE**

#### **Statusi i shfrytëzimit të banesës**

*Aranzhimi sipas të cilit ekonomia familjare e shfrytëzon njësinë e banimit.*

#### **Formë tjetër e shfrytëzimit**

*Ekonomia familjare e shfrytëzon tërë apo një pjesë të njësisë së banimit sipas ndonjë forme të shfrytëzimit, p.sh, kur njësia banesore i është dhënë ekonomisë familjare pa pagesë nga punëdhënësi ose nga ndonjë i afërm.*

#### **Toka në pronësi apo në shfrytëzim**

*Të gjitha sipërfaqet e tokës në pronësi ose në shfrytëzim nga ekonomia familjare, toka e regjistruar nuk duhet domosdoshmërisht të jetë në të njëjtën komunë ku jeton ekonomia familjare, ajo mund të jetë edhe në ndonjë komunë tjetër të Kosovës.*

### **KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERSONAVE**

#### **Gjinia**

*I referohet gjinisë së personit*

#### **Vendbanimi i zakonshëm i nënës në kohën kur ka lindur personi i intervistuar**

*Vendi ku është menduar se do të rritet personi pas lindjes së tij. Kjo variabël e zëvendëson variablën e zakonshme «vendi i lindjes» sepse në Kosovë, shumë fëmijë lindin në spitale që gjenden në zonat e mëdha urbane dhe vendi i lindjes është më pak indikativ se sa vendbanimi i nënës në kohën e lindjes së fëmijës.*

#### **Përkatësia etnike/kulturore**

*I referohet identitetit të një grupi njerëzish, pjesëtarët e të cilit identifikohen me njëri tjetrin përmes trashëgimisë së përbashkët e cila përbëhet nga kultura dhe zakonet e përbashkëta, duke përfshirë edhe gjuhën apo dialektin e përbashkët*

#### **Religjioni**

*Përmbledhje e sistemeve kulturore, sistemeve të besimit dhe pikëpamjeve botërore që lidhin njerëzimin me vlerat shpirtërore, e ndonjëherë edhe ato morale.*

---

### Gjuha amtare

Gjuha e parë që personi e ka mësuar pas lindjes dhe të cilën akoma e flet.

### Vendi i shtetësisë

Shteti me të cilin personi ka një lidhje të veçantë ligjore, e cila është fituar sipas lindjes ose natyralizimit, qoftë përmes deklaramit, zgjedhjes, martesës ose ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar me legjislacionin shtetëror.

### Statusi i aktivitetit të tanishëm

Të punësuarit që i shtohen atyre të papunë e përbëjnë popullsinë aktive, po ashtu të quajtur fuqi punëtore. Statusi i aktivitetit sipas përkufizimeve të ILO-s e ndan popullsinë në tri grupe: të punësuar, të papunë dhe persona joaktivë.

### Ekonomikisht aktive

Popullsia ekonomikisht aktive përfshinë të gjithë personat e të dy gjinive mbi një moshë të caktuar, të cilët sigurojnë fuqinë punëtore në tregun e punës për aktivitete prodhuese (që kanë kaluar kufirin prodhues të sistemit), gjatë një periudhe të caktuar referuese. Kjo përfshinë të gjithë personat që plotësojnë kushtet për tu përfshirë në mesin e të punësuarve (punonjës ose të vetëpunësuar) ose të papunëve.

### I punësuar

Një person konsiderohet i punësuar nëse ai apo ajo ka punuar së paku një orë në javën referuese, ose nuk ka punuar për shkak të pushimit, sëmundjes, etj, por i cili normalisht është i punësuar. Personat që mungojnë për një kohë më të gjatë, si psh, femrat në pushim të lehonisë, përfshihen në kategorinë e personave të punësuar nëse e kanë ndonjë lidhje formale me vendin e punës.

### I papunë

Një person konsiderohet i papunë nëse ai apo ajo nuk është i/e punësuar në kuptimin e përcaktuar, nëse është duke ndërmarrë hapa aktivë për të gjetur punë dhe është në gjendje që të fillojë të punojë brenda një afati të shkurtër.

### Nuk është ekonomikisht aktiv (i quajtur edhe joaktiv)

Personat që nuk konsiderohen të punësuar ose të papunë në periudhën e vëzhguar, p.sh, nxënësit me orar të plotë, studentët, amviset, pensionistët, personat në shërbim të obliguar ushtarak, etj.

### Profesioni kryesor

Sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Profesioneve (ISCO), që është njëri prej klasifikimeve standarde ndërkombëtare të ILO-së. ISCO është instrument për organizimin e vendeve të punës në një grup të qartë të detyrave dhe funksioneve që kryhen në një punë.

### Industria kryesore

Sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE, Rev 1.1). NACE është pjesë e një sistemi të integruar të klasifikimit statistikor i zhvilluar kryesisht nën përkujdesjen e Divizionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë ISIC-në për klasifikimin industrial standard ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara të të gjitha aktiviteteve ekonomike. Ky klasifikim i referohet aktivitetit kryesor ekonomik ose shërbimit kryesor të ofruar nga punëdhënësi për të cilin punon një person.

### Burimi kryesor i mjeteve për jetesë gjatë vitit para regjistrimit

Mjetet financiare me të cilat një person jeton ose mban familjen ose grupin.

### Puna

Çdo aktivitet prodhues ose operativ që ka për qëllim të shërbejë si mjet për të fituar për jetesë.

### Prona, investimet

Përfshinë qiranë nga pasuria e patundshme, interesat financiare, fitimet nga transaksionet financiare, etj.

### Pensioni

Pensioni është shumë fiks që i paguhet rregullisht një personi, pas pensionimit nga vendi i punës dhe që menaxhohet nga një Agjenci Shtetërore (fondi pensional).

---



**Transfere të tjera**

*Përfshinë kompensimet për personat e papunë, ndihmën ekonomike për sëmundje apo pushim të lehonisë, bursat).*

**Paratë e dërguara nga jashtë**

*Paratë e dërguara nga jashtë janë paratë që një punëtor jashtë vendit i dërgon në vendin e tij.*

**Mbështetje nga persona të tjerë**

*Duke përjashtuar paratë e dërguara nga jashtë.*

**Burime të tjera**

*Përfshinë fitimet nga bixhozi, trashëgiminë.*

**Lista e simboleve**

%	Përqindja
‰	Për mijë (promil)
1-4	Klasa e thjeshtë e numrave të plotë; p.sh nga 1 deri në 5, duke përjashtuar 5-in.
0-4	Grup intervali
90+	Nëntëdhjetë e mbi
<18	Më e vogël (me pak) se tetëmbëdhjetë
0.0-5	Klasat me numra real (jo të plotë); p.sh. 0 deri në 5 ari, ku vlerat mund të kenë njësi dhjetore deri në 5, si 2.5, por janë numër i plotë në 5.
:	Të dhënat nuk janë në dispozicion; p. sh. Kur të dhënat për një vendbanim të caktuar janë shumë të vogla për t'u publikuar pa e cenuar konfidencialitetin apo si te tilla mungojnë ( Mungojnë të dhënat )
0	E dhëna është më e vogël se 0,5 te njësisë së dhënë të matjes

**Lista e emërtimeve**

Nuk janë në dispozicion	Nëse të dhënat nuk janë raportuar gjatë mbledhjes së të dhënave, për to thuhet se «Nuk janë në dispozicion».
Nuk aplikohen	Nëse të dhënat e paraqitura në tabelë nuk kanë të bëjnë me një kategori të caktuar, për to thuhet se: «Nuk aplikohen»; p.sh. Mashkull- për të dhënat për fëmijët që i ka lindur.

# INFORMACION I PËRGGJITHSHËM

## Rreth regjistrimit

Regjistrimi është aktiviteti kryesor statistikor që jep mundësi për të marrë informacione më të plota rreth popullsisë në një kohë të caktuar. Ai është burimi më i rëndësishëm i të dhënave në lidhje me madhësinë dhe kushtet socio-ekonomike të një vendi.

Regjistrimi i popullsisë duke filluar nga planifikimi, realizimi i tij si dhe analizimi e shpërndarja e të dhënave është një ndër aktivitetet më të rëndësishme dhe komplekse për një vend dhe vlerësohet si operacioni më i madh i një vendi në kohë paqeje.

Njëkohësisht, regjistrimi është aktiviteti më i madh statistikor që ne mund ta mendojmë, pasi ai prek çdo individ dhe familje në vend.

Pra, regjistrimi është aktiviteti i vetëm që jep një pasqyrë të detajuar për popullsinë, dhe është unik, sepse ai mbulon të gjithë në të njëjtën kohë, pyetjet janë unike gjë që e bënë të lehtë krahasimin e pjesë të ndryshme të një vendi.

Te dhënat e dala nga regjistrimi në nivel kombëtar do t'i ofrojnë qeverisë qendrore, lokale, institucioneve e organizatave, bizneseve e grupeve të interesit, institucioneve hulumtuese e akademike, analistëve, individëve e autoriteteve të tjera një pasqyrë gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë në përgatitjen e planeve, strategjive, analizave e hulumtimeve të tyre, siç janë ato për strehimin, shkollimin, shëndetin, shërbimet e ndryshme, transportin, përpilimin e projekteve etj.

Në nivelin ndërkombëtar, regjistrimi i popullsisë është thelbësor për të vlerësuar gjendjen e kushteve socio-ekonomike të një vendi si dhe për monitorimin e marrëveshjeve dhe negociatave multilaterale ekonomike e politike.

Regjistrimi po ashtu përdoret edhe si pikë referimi për shumë seri të tjera statistikore siç janë vlerësimet e popullsisë dhe parashikimet. Regjistrimi njëkohësisht përfaqëson një element shumë të rëndësishëm të vetë infrastrukturës statistikore, pasi që rezultatet e tij mundësojnë, që të nxjerrin mostra proporcionale për çdo anketë, që i merr për bazë ekonominë shtëpiake si njësit tjera themelore. Po ashtu, regjistrimi mundëson ngritjen e kapaciteteve dhe është një përvojë e nevojshme për vetë institucionin e statistikave.

### **Legjislacioni**

Përgatitja e legjislacionit ishte më se e nevojshme për të zbatuar një regjistrim të suksesshëm. Kuvendi i Kosovës më miratoi 11. 07. 2003 Ligjin e parë për Regjistrimin e Popullsisë nr. 2003/16. Ky ligj hapi rrugën për realizimin e regjistrimit të popullsisë në Kosovë. Sipas këtij ligji dhe duke ndjekur praktikën e vendeve të tjera, institucioni zyrtar i ngarkuar me realizimin e regjistrimit të popullsisë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Me aprovimin e Rregullores nga ana e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës nr. 763/2008 (9 qershor 2008) vendet e BE-së, vendet kandidatë, si dhe ato kandidatë potenciale për integrim në BE, janë të obliguara që ta respektojnë dhe ta aplikojnë metodologjinë sipas kësaj Rregulloreje për raundin e regjistrimeve të vitit 2010.

Në këtë rregullore janë specifikuar definicionet, si: popullsia, banesat, ndërtesat, popullsia banuese etj.

Duke u bazuar në nevojën për rishikimin e ligjit, si dhe harmonizimin e tij me legjislacionin e BE-së për regjistrimin e popullsisë, Ligji i mëparshëm i regjistrimit (nr. 2003/16) është modifikuar gjatë periudhës 2009-2010 me mbështetjen e EUROSTAT-it dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës miratoi Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë më 4 gusht 2010, ndërsa në nëntor të vitit 2010 Parlamenti i Kosovës e miratoi këtë ligj (me numër 03/L-237), duke inkuorporuar rekomandimet e Rregullores së BE-së në fjalë. Regjistrimi i popullsisë, i realizuar në prill të vitit 2011, është bazuar në këtë ligj<sup>4</sup>.

### **Financimi i projektit të regjistrimit**

Kostoja totale e projektit është parashikuar të jetë rreth 10.7 milionë €.

Projekti i regjistrimit të popullsisë është financuar nga Qeveria e Kosovës dhe një varg donatorësh. Mjetet janë grumbulluar në një fond të mirëbesimit, i cili është menaxhuar nga UNOPS-i.

### **Historik i shkurtër për regjistrimet në Kosovë**

Të dhënat statistikore për një vend janë të rëndësishme në kohë. Zakonisht praktikën me të mira sugjerojnë që regjistrimet janë të nevojshme të realizohen çdo dhjetë vjet duke u bazuar në faktin se gjatë kësaj periudhe ndodhin ndryshime të theksuara.

Regjistrimi i parë në Kosovë është realizuar në vitin 1948 dhe më pas në vitin 1953, datë nga e cila ai filloi të realizohet çdo dekadë: 1961, 1971, 1981. Në vitin 1991 regjistrimi i popullsisë nuk u realizua në Kosovë; si rrjedhojë e largimit nga puna të punëtorëve shqiptarë dhe zbatimit të masave të dhunshme

---

<sup>4</sup> Për më shumë shih ne ueb faqen e ASK-së: Ligji për regjistrimin e popullsisë, te ekonomive familjare dhe banesave si dhe Raporti i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe i banesave në Kosovë 2011 (faqe 6-9)

## KAPITULLI 1 Informacion i përgjithshëm

---

të futura në atë kohë nga ish-Jugosllavia (Serbia) në të gjitha institucionet e Kosovës duke përfshirë edhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës, popullsia refuzoi të marrë pjesë në të. Në atë kohë, Enti Federativ Jugosllav (me vendndodhje në Serbi) kishte bërë vlerësime për të matur popullsinë e Kosovës. Ky regjistrim nuk ishte pranuar as nga institucionet e Kosovës e as nga ato ndërkombëtare.

Ne vitin 2001, Kosova sapo kishte dalë nga lufta (1998-99) dhe kishte vështirësi që të organizoj një regjistrim të mirëfilltë për shkak të jo-stabilitetit mbizotërues dhe për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullsisë (brenda dhe jashtë Kosovës).

